



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i njohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e 85-të, të mbajtur më 12.04.2023, morri vendimin vijues:

## VENDIM

Procedura sipas lëndës me numër 12-2372/1 të datës 07.07.2020, e formuar sipas denoncimit të dorëzuar për personat ///, /// и ///, gjyqtar në gjykatën e apelit ///, **NDËRPRITET.**

KSHPK-ja konstatoi se nuk ka elemente për veprime të mëtutjeshme sipas lëndës – për rastin e lëndës tashmë ka vepruar organi tjetër kompetent.

Lënda me numër 12-2372/1 të datës 07.07.2020 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi të publikohet në formë të depersonalizuar në faqen e internetit të KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga miratimi i tij.

## Arsyetim

Nga një parashtrues i njohur, më datë 07.07.2020 është dorëzuar denoncim për zyrtarët ///, /// dhe ///, gjyqtarët e Gjykatës së Apelit /// dhe është konstatuar rasti me numër 12-2372/1 datë 07.07.2020.

Pretendimet në denoncim i referohen dyshimeve për paligjshmëri të kryera nga gjyqtarët në Gjykatën e Apelit /// në proceset gjyqësore të nisura nga paditësit ///, ///, /// dhe /// nga s. /// para Gjykatës së Apelit /// (///), në të cilën u ndryshua Aktgjykimi i Gjykatës së Shkallës së Parë /// (/// i ///) dhe u vendos se padia e paditësit pranohen dhe i padituri është në borxh /// t'u kthejë dhe t'u dorëzojë pasurinë e paluajshme të përshkruar në aktgjykim.

Parashtruesi thekson se e njëjta përbërje gjyqësore më parë në procedurë për /// ndërmjet palëve të njëjta për të njëjtën çështje juridike ka vërtetuar një vendim të Gjykatës Themelore /// (/// të ///) ku pretendimi i i është refuzuar si i pabazuar paditësit (Vendimi / ///).

Me qëllim të verifikimit të pretendimeve dhe përcaktimit të gjendjes faktike në rastin e raportuar, KSHPK-ja i ka dorëzuar Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut kërkesë për mbledhjen e të dhënave dhe informatave, me të cilën ka kërkuar që Këshilli të rishqyrtojë veprimet e gjyqtarëve. në procedurën e treguar dhe së cilës i ka bashkangjitur dokumentacionin bashkëngjitur kërkesës.

Nga shqyrtimi i përgjigjes së dorëzuar nga Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut është konstatuar gjendja faktike si në vijim:

Parashtruesi i denoncimit i është drejtuar edhe Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, i cili ka vepruar në përputhje me kompetencat e tij ligjore, dhe e ka shqyrtuar ankesën në seancën e Këshillit të mbajtur më ///. Këshilli konkludoi se nuk kishte elemente të sjelljes joprofesionale dhe të pakujdesshme nga ana e gjyqtarëve që kanë vepruar në rastin konkret, për të cilin është njoftuar kërkuesi (Njoftimi /// i /// viti).

Nga sa u tha më lart, KSHPK-ja konstatoi se nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm lidhur me rastin për shkak se për rastin në fjalë tashmë ka vepruar organi tjetër kompetent dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Dorëzuar:

- parashtruesit të denoncimit

Përpiloi: A.R.M.

miratoi: G.T., anëtar i KSHPK-së

**KOMISIONI SHTETËROР ПЁР  
PARANDALIMIN E KORRUPSIОНИТ**

**Kryetar,  
Biljana Ivanovska**